



TOGETHER FOR LIFE

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 2009
- Statusi Ligjor: Organizatë joqeveritare
- Selia Qendrore: Rr. Brigada VIII, Pallati Jeshil, Tekno-Projekt, Shk. 2, Ap. 14, Tiranë/ Shqipëri
- Faqja e Internetit: <http://togetherforlife.org.al/>
- Email kryesor i organizatës: info@togetherforlife.org.al
- Telefoni kryesor i organizatës: +355 692 066 522

2. Misioni

TFL punon me njerëzit dhe komunitetet për të promovuar një shoqëri të drejtë dhe të barabartë që garanton të drejtat dhe realizimin e tyre.

3. Vizioni (Opsionale)

Vizioni i TFL është një shoqëri ku njerëzit gëzojnë të drejtat e tyre, vlerësohen dhe trajtohen në mënyrë të barabartë dhe ku ata mund të marrin pjesë plotësisht për të realizuar potencialin e tyre të plotë shoqëror, ekonomik dhe kulturor.

4. Fushat Kryesore të Fokusit

- Shëndeti publik dhe përgatitja për emergjencat shëndetsore
- Mbrojtja e Mjedisit
- Transparenca dhe llogaridhënia
- Të drejtat e njeriut
- Fuqizimi i komunitetit

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

Një përshkrim i shkurtër i projekteve, nismave ose programeve kryesore që organizata zhvillon ose ka zhvilluar:

- *Projekti 1: REST-ART - Rritja e Qëndrueshmërisë Mjedisore ndëpërmjet Artit* – projekt inovativ që ka synuar të promovojë qëndrueshmërinë mjedisore përmes fuqisë së artit. Projekti ka kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve për mbrojtjen e mjedisit, krijimin e modeleve të reja të sjelljes dhe motivimin i të rinjve për pjesëmarrje aktive në përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit, si edhe në krijimi e veprave artistike nga plastikat njëpërdorimshe, si një mjet për të trajtuar degradimin mjedisor përmes artit.
- *Projekti 2: "Ajër i pastër, jetë e shëndetshme!"* - kontriboi në krijimin e rrjetit kombëtar të OJF-ve për të adresuar problematikat që lidhen me cilësinë e ajrit, përmes aksesit dhe transparencës në informacion dhe advokimit për forcimin e kuadrit rregullator në sektorin e ajrit. Projekti monitoroi 4 parametra kryesorë të lidhura me cilësinë e ajrit (PM2.5, PM10,



TOGETHER FOR LIFE

CO₂, NO₂) në bashkitë Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë dhe Shkodër dhe përditësoji platformën www.greenlungs.al.

- *Projekti 3: “Mbrojtja e biodiversitetit nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve të gazetarëve”* - qëllimi kryesor i projektit ishte të kontribuonte në rritjen e ndërgjegjësimit për kërcënimet ndaj biodiversitetit dhe zgjidhjeve të bazuara në ruajtje duke përhapur lajme dhe informacion cilësor. Ky qëllim është realizuar duke rritur kapacitetin e gazetarëve që punojnë në media kombëtare/lokale dhe organizatave mediatike për çështjet e biodiversitetit dhe ruajtjes së mjedisit.
- *Projekti 4: “Jehona rinore për shëndet dhe mjedis”*. Ky projekt ka pasur në fokus promovimin e stilit të jetesës së shëndetshme tek të rinjtë dhe sigurimi i një mjedisi socio-kulturor që mundëson dhe mbështet stilin e jetesës së shëndetshme. Ky qëllim është arritur duke krijuar grupet e ambasadorëve të eko-shëndetit në shkollat e mesme të Tiranës dhe ngritur kapacitetet e tyre për të vepruar si agentë për ndryshimin e sjelljes së të rinjve bashkëmoshatarë lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin.

6. Shtrirja Gjeografike

Një përshkrim i shkurtër e vendeve ku operon organizata ose ku ka projekte aktive (vendet specifike, rajonet, qytetet).

Together for Life është një organizatë që punon në gjithë Shqipërinë. Për të lehtësuar punën e organizatës TFL ka të kontraktuar 5 koordinatorë lokalë të cilët janë përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve në terren. Aktualisht projektet e TFL po zbatohen në Tiranë, Shkodër, Pukë, Fushë-krugë, Përmet, Mamurras, Elbasan, Gramsh, Lezhë, Kukës.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Eglantina Bardhi

Bordi i Drejtuesve: Rajmonda Dalipaj ; Bora Trakaj; Entela Barjamaj; Ambri Pelinku; Silvi Dervishi.

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

Një përmbledhje e shkurtër që thekson partnerët, donatorët ose bashkëpunëtorët kryesorë që ka patur organizata.

Që nga viti 2009, TFL ka koordinuar dhe zbatuar me sukses qindra projekte në nivel kombëtar dhe evropian, me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm si: Organizata Botërore e Shëndetësisë, Bashkimi Evropian, Programi Erasmus+, Këshilli i Evropës, Fondacioni Evropian për të Rinj, National Endowment for Democracy etj. Gjithashtu me mbështetjen e ambasadave të ndryshme që Shqipëri, si ajo e SHBA-së, Holandës, Suedisë, Zvicrës etj. Bashkëpunim të ngushtë për zbatimin e aktiviteteve të saj TFL ka me institucionet e pavarura që veprojnë në Shqipëri si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Avokati i Popullit etj., si edhe me organizata të shoqërisë civile që kanë të njëjtën fokus pune.



TOGETHER FOR LIFE

9. Ndikimi (Opsionale)

Theksoni ndonjë rezultat të matshëm, statistika, ose arritje të rëndësishme. Për shembull:

- Ngritja e kapacitetit të 27 organizatave në rang kombëtar për të advokuar për rritje të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve lokale dhe qendrore.
- Ngritja e 5 rrjeteve të qëndrueshmërisë së komunitetit (CRNs) në zonat e Pukës, Dajçit, Gramshit, Përmetit dhe Fushë-Krujës, të cilat tani funksionojnë si modele të qëndrueshme për reagimin ndaj emergjencave shëndetësore të udhëhequra nga vetë komuniteti.

10. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)

Çdo zhvillim i fundit, çmime ose shfaqje në media për organizatën.

Në datën 3 Qershor 2025 TFL është vlerësuar me çmimin Western Balkans R&I Youth AWARD, dhënë nga projekti POLICY ANSWERS me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian, për zbatimin me sukses të projektit Fashionation si një nga iniciativat më të suksesshme inovative të drejtuara nga të rinjtë në Ballkanin Perëndimor.



TFL në media:

2 Qershor 2025

<https://shqiptarja.com/lajm/raporti-i-together-for-life-ryshfeti-ne-shendetesi-shqetesues-frika-ndalon-denoncimet-e-korrupsionit-te-anketuarit-japim-para-pasi-kemi-frike-per-shendetin>

<https://politiko.al/e-tjera/tfl-publikon-raportin-83-e-shqiptareve-e-perceptojne-shebdetesine-ne-shq-i533197>

TOGETHER FOR LIFE



TFL publikon raportin: 83% e shqiptarëve e perceptojnë shëndetësinë të korrupshtuar

POLITIKO
2 QERSHOR 2025, 17:55



11 Prill 2025

